



01Nr. 104/02-15103/26
Datë 23.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit 04/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8.7 të Rregullores me nr. 06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I. Me këtë vendim iu ndahen subvencione përfituesve në bazë të thirrjes publike në programin "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla" me Nr.10-104/02-10634 të datës 08.05.2026, sipas rekomandimit nga Komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit me Nr.01-104/02-13651 të datës 10.06.2026.

II. Përfituesit si në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Ajnure Kuka;
2. Arijeta Bajramaliu;
3. Bleron Zharku;
4. Diana Luzha;
5. Ergin Topojani;
6. Faruk Zharku;
7. Fazli Berisha;
8. Florent Haxhija;
9. Florije Kyqyku;
10. Gonxhe Kuqi;
11. Jona Stagova;
12. Kosovare Krasniqi;
13. Misim Loki;
14. Njomza Tusha Zharku;
15. Rasim Baftiu;
16. Suad Berisha;
17. Trim Shehu.

III. Shuma totale e mjeteve financiare për subvencionim të përfituesve të lartcekur është 35,402.08 €.

IV. Pagesat për përfituesit do të kryhen nga Kodi Ekonomik – Subvencione dhe Transfere, nënprogrami i Planifikimit të Zhvillimit Ekonomik.

V. Marrëveshjet individuale me përfituesit do të lidhen konform dispozitave ligjore neni 13, Rregullorja Nr.06/2016, nga Kryetari i Komunës duke u bazuar në këtë vendim dhe në kompetencat ligjore që ka.

Arsyetim

Me datë 10.06.2026, Komisioni për ndarjen e subvencioneve në DZHET ka bërë Rekomandim me Nr.01-104/02-13651 për ndarjen e subvencioneve për 17 (shtatëmbëdhjetë) aplikantë fitues dhe ka refuzuar 14 (katërmëdhjetë) nga aplikacionet. Duke respektuar afatin e ankesave, gjatë të cilit Komisioni kompetent ka pranuar dhe shqyrtuar ankesat e parashtruara brenda afatit ligjor, me kompetencë të plotë ka vendosur lidhur me to. Pas shqyrtimit të ankesave dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ankesat janë refuzuar me vendim, sipas vlerësimit dhe konstatimeve të Komisionit kompetent.

Bazuar në rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve, rezultatet e procedurës së ankesave dhe dispozitat ligjore në fuqi, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



Kryetari i Komunës

Sabedin Vishi